




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-3235/15</u>
Nr. l. faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>12.10.2015</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	12/10/2015
REFERENC-Ë:	AKK – DPK – DPKPP – 03-03/3015/15
PËR/ZA/TO:	z. Dragisha LAKIÇEVIQ Drejtor i Prokurimit - Komuna Lepasaviq
CC:	z. Dragan JABLANOVIQ Kryetar Komune – Komuna Lepasaviq
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull: “Furnizimi me dy mjete të rënda të transportit (për zjarr fikje dhe kamion për mbledhje të mbeturinave) dhe furnizimi me një auto ambulancë për nevoja të Komunës së Lepasaviqit”



I nderuar z. LAKIÇEVIQ

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Furnizimi me dy mjete të rënda të transportit (për zjarre fikje dhe kamion për mbledhje të mbeturinave) dhe furnizimi me një auto ambulancë për nevoja të Komunës së Lepasaviqit” me numër prokurimi: 641/15/011/111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: “Furnizimi me dy mjete të rënda të transportit (për zjarr fikje dhe kamion për mbledhje të mbeturinave) dhe furnizimi me një auto ambulancë për nevoja të Komunës së Lepasaviqit” me numër prokurimi: 641/15/011/111, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Komunën e Leposaviqit, ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull "Furnizimi me dy mjete të rënda të transportit (për zjarre fikje dhe kamion për mbledhje të mbeturinave) dhe furnizimi me një auto ambulancë për nevoja të Komunës së Leposaviqit" me numër prokurimi: 641/15/011/111, i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së më datë 30/09/2015 në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik pranë Agjencisë kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, Agjenci ka hasur në një kriter i cili nuk është në pajtim me Legjislacionin në fuqi.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga ana e Autoritetit kontraktues ka konstatuar se: Në Njoftim për Kontratë dhe në dokumentet e dosjes së tenderit tek rubrika III.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 1, autoriteti kontraktues ka kërkuar: "*Raport mbi dëshmitë e qarkullimit financiar për 3 vitet e fundit (2012,2013 dhe 2014, minimum 1.000.000,00 euro)*" kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me legjislacionin në fuqi. Autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kritereve të përzgjedhjes të kërkojë dëshmi nga Operatorët ekonomik me të cilat do ta vërtetonte aftësinë e tyre ekonomike - financiare, por nuk është e lejuar që si qarkullim financiar të kërkojë shumën e cila e kalon dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 dhe nenin 5 Gjendja ekonomike dhe Financiare e Udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !